



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.332, datë 19.12.2022

PËR

**“SHPALLJEN E PESË VENDEVE VAKANTE PËR PROCEDURËN E
TRANSFERIMIT NËPËRMJET LËVIZJES PARALELE NË PROKURORINË
PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TIRANË”**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 43 pikat 1 dhe 2, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenin 5 të Rregullores “Mbi transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele” e ndryshuar, si dhe relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Të shpallë fillimin e procedurave për plotësimin e pesë pozicioneve vakante si më poshtë:
 - a) Pozicion vakant Nr.1 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë
 - b) Pozicion vakant Nr.2 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë
 - c) Pozicion vakant Nr.3 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë
 - ç) Pozicion vakant Nr.4 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë
 - d) Pozicion vakant Nr.5 në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë
2. Subjektet të cilët kanë të drejtë të kandidojnë, kriteret që duhet të plotësojnë, afati i dorëzimit të shprehjes së interesit, dokumentacioni që duhet të dorëzojnë dhe adresa ku do të dorëzohet shprehja e interesit, do të njoftohet në faqen zyrtare të Këshillit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë, sot më 19.12.2022.

KRYETAR

Alfred Balla

